



Prishtinë: 29.12.2009

Kodi i ZRRE-së: V_222_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_309_11_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimi i DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_309_11_09
5. Apelimi i konsumatorit me datë 04.12.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2009 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Murat Rushitit (shifra e konsumatorit **DFE - 110102**) nga Shtimja , si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 27.04.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 31.03.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 09.12.2007 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar njehsorin elektrik me nr. 7047693, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit në Prishtinë dhe se kanë regjistruar të gjitha pajisjet elektrike të inventarizuara.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 076076 të datës 09.12.2007
- Me datë 17.04.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori për inspektimin e pikës matëse dhe kanë konstatuar se me kërkesë të shërbimit të kalibrimit bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik, ku hiqet njehsori i vjetër dhe dërgohet në kalibrim, ndërsa vendoset njehsori i ri.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 068662 i datës 17.04.2008
- Me datë 17.04.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja e energjisë elektrike njehsorin e vjetër nr. 7047693 dhe kanë vendosur njehsorin e ri nr. 4694014.
Provë: Vërtetimi i ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 003806

- Me datë 03.11.2008 zyrtarët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7047693, ku gajtë kontrollimit është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllobat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, përreth qelqit nga ana e epërme është futur shiriti filmik, ku është penguar puna e diskut kurse në brendi të njësorit ka shirit dhe pluhur të shiritit filmik.
Provë: Procesverbali me nr. 6/3 të datës 03.11.2008
- Me datë 30.12.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE08HP04173 në vlerë prej 1,881.77 €.
Provë: Fatura DFE08HP04173 e datës 30.12.2008
- Me datë 15.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 31.03.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 31.03.2009
- Me datë 27.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 23.10.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar pjesërisht ankesën e tij.
Provë: Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_309_11_09
- Me datë 04.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_309_11_09
Provë: Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_309_11_09 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së, por që duhet të bëhet rillogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar duke marrë parasysh diferencën e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër nr. 4694014 (periudha 05/2007 – 04/2008) dhe me njehsor të ri nr. 70478693 (05/2008 – 04/2009).

Arsyetimi i rillogaritjes së faturës së shfrytëzimit të paautorizuar bëhet pasi që sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive vërehet se për periudhën kohore të ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar nuk është bërë lexim i rregullt i njehsorit elektrik. Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive të konsumit të konsumatorit del se diferenca mes konsumit me njehsor të vjetër dhe të ri është **190 KWh**. Kjo sasi e energjisë duhet t'i faturohet konsumatorit si ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar dhe duke u kthyer mbrapa për 12 muaj, e kjo sipas llogaritjeve del se konsumatori duhet të faturohet me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar në vlerë prej 93.62 €.

Në bazë të analizave të cekura më lartë, Bordi i ZRRE-së **aprovon pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

- KEK-u duhet që faturën DFE08HP04173 të ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar ta korrigjoj dhe se vlera për të cilën KEK-u duhet ta faturoj konsumatorin është 93.62 €.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Ferizaj, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimet të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar